



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:250374

Datë: 08.07.2024

Numri i dokumentit: 05909527

PAKR.nr.312/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Kadrije Goga Lubishtani, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Endrit Ajeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.G., nga Prishtina, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 173 par.1 pika 1.3 lidhur me pikën 1.4 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit I.G., av.Myrvete Hashani Jashari, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.299/2023, të dt.17.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.04.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit I.G., av.Myrvete Hashani Jashari, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.299/2023, të dt.17.04.2024, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.299/2023, të dt.17.04.2024, është shpallur fajtor i akuzuari I.G., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 173 par.1 pika 1.3 lidhur me pikën 1.4 të KPK, dhe i shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 35 (tridhjetë e pesë) viteve.

Në dënimin e shqiptuar me burgim, të akuzuarit I.G., i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 25.11.2022, e gjerë në përfundim të dënimit të shqiptuar.

Të akuzuarit I.G., i është vazhduar masa e paraburgimi deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar.

Është obliguar i akuzuari, që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 50 Euro, si dhe shumën prej 50 Euro, në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit i është konfiskuar arma e ftohtë – sëpata e përdorur për kryerjen e veprës penale dhe e njëjta duhet të shkatërrohet.

E dëmtuara A.(I.)G., nga Podujeva, rr. “.....”, pa numër, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit I.G., av. Myrvete Hashani Jashari, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve të ligjit penal, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal dhe për shkak të shpenzimeve të procedurës penale, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet, ashtu që çështja penale ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje, ose i njëjti të ndryshohet, ashtu që të hedhet aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, dhe ndaj të akuzuarit të pushohet procedura penale.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.293/2024, të datës 07.06.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar nga ana e Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.299/2023, të dt.17.04.2024, të vërtetohet.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.04.07.2024, dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar, i akuzuari I.G., i cili është sjellë nga qendra e paraburgimit, mbrojtësja e të akuzuarit, av.Myrvete Hashani Jashari, përfaqësuesi i mbrojtjes së viktimave, ndërsa nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit, si dhe e dëmtuara, edhe pse kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Mbrojtësja e të akuzuarit I.G., av.Myrvete Hashani Jashari, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë ankesës së ushtruar, duke theksuar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, nuk i ka evituar mangësitë nga aktgjykimi i kaluar, përkundër asaj që kjo çështje penale është anuluar njëherë, por rezulton se në aktgjykimin e nxjerrë, prapë janë manifestuar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

I akuzuari I.G., deklaron se e mbështet në tërësi ankesën e ushtruar nga ana e mbrojtëses së tij, av.Myrvete Hashani Jashari, si dhe paraqitjen e tij në seancë të kolegjit.

Mbrojtësi i viktimave, ka deklaruar se mbetet pranë paraqitjes së prokurorit të shtetit, duke theksuar se nuk ka çka të shtoj më shumë nga kjo çështje penale.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, nga ana e mbrojtëses së të akuzuarit I.G., av.Myrvete Hashani Jashari, aktgjykimit të ankimuar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit I.G., av.Myrvete Hashani Jashari, nuk është e bazuar

Sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit I.G., av.Myrvete Hashani Jashari, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 384 par.1, konkretisht par.2 nën par.2.1 lidhur me nenin 369 par.7 të KPPK, ngase gjykata e shkallës së parë, nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye konsiderohen të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Po ashtu nga ana e gjykatës së shkallës së parë, nuk janë dhënë arsye përkritazi me vlerësimin e saktësisë së provave kundërthënëse, arsyet e mos miratimit të propozimeve konkrete të palëve, në të cilat mund mbështetet zgjedhja e çështjes penale, përkatësisht për të vërtetuar ekzistimin e elementeve inkriminuese të së njëjtës si dhe përgjegjësisë penale juridike. Sa i përket propozimeve, përkundër asaj që mbrojtësja e të akuzuarit, ka propozuar që të caktohet një ekspert për të dhënë ekspertizën psikiatrike, për të akuzuarin, si dhe arsyet në të cilat është bazuar zgjedhja e çështjes juridike për të vërtetuar ekzistimin e përgjegjësisë penale, e njëjta çështje nuk është aprovuar, andaj në këtë drejtim ka mbetur pa u sqaruar gjendja shëndetësore e të akuzuarit, përkatësisht veprimet e ndërmarra në drejtim të të dëmtuarës A.G.. Po ashtu në shqyrtimin gjyqësor është kërkuar që të bëhet shikimi psikiatrik, për të bërë një ekspertizë psikiatrike, duke pasur parasysh gjendjen tejet të rënduar të akuzuarit, për nga ana e gjykatës së shkallës së parë, nuk është kryer një ekspertizë e tillë, por ka mbetur pa u sqaruar kjo çështje e cila ndikon drejtpërdrejt në marrjen e një vendimi më të drejtë. Në këtë çështje penale ekziston raporti i institutit të psikiatrisë forenzike në Prishtinë në këtë çështje penale, ku është konstatuar se është filluar me dt.01.12.2022, dhe ka zgjatur gjerë me dt.15.02.2023, rezulton se vet instituti i psikiatrisë forenzike në Prishtinë, nuk i është përmbajtur afatit prej dy jave, të caktuar sipas urdhëresës PPRKR.nr.644/2022, të dt.29.01.2022, që nënkupton se janë shkelur dispozitat ligjore nga neni 134 par.7 i KPPK, por ekspertiza është vonuar dhe është shkelur edhe neni 136 i KPPK. Gjykata po qesë bënë zgjatjen e periudhës kohore të ekspertimit, atëherë duhet të veproj sipas dispozitave ligjore nga neni 135 par.1 të KPPK, dhe të respektohen afatet ligjore që nënkupton se nga ana e institutit të forenzikës nuk është mbuluar veprimi juridik, i ndërmarrë nga ana e të njëjtit për zgjatjen e afatit për dhënien e ekspertizës. Nga shkresat e lëndës rezulton se kanë kaluar plotë 77 ditë, që nga data 01.12.2022, gjerë me dt.15.02.2023, andaj si i tillë raporti nuk është brenda afatit ligjor dhe është i mangët, që mund të vërehen në faqen, 2,3, dhe 4, dhe e ka vështirësuar pozitën e mbrojtëses së të akuzuarit, pasi që nuk janë respektuar afatet ligjore.

Prokuroria gjatë hetimeve me dt.01.02.2023, ende pa pranuar raportin e ekzaminimit psikiatrik, i ka njoftuar palët, përkritazi me veprën penale të kryer, për të deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë, apo mos pranimin e së njëjtës, mirëpo pa e pranuar raportin nuk kemi mundur të deklarohemi ngase kemi pasur një person i cili ka aftësi jo të plota psikike, andaj nuk është ne gjendje për të kuptuar rrjedhën e procedurës penale. Edhe me dt.12.05.2023, na u është drejtuar gjykata, dhe nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake është pranuar raporti i ekzaminimit

psikiatrik, përkitazi me të akuzuarin, andaj kemi qenë në pritje të marrjes së një ftese nga ana e prokurorisë, që të deklarohemi në kuptim të nenit 119 lidhur me nenin 129 të KPPK.

Me dt.18.05.2023, në zyre është pranuar ftesa e Gjykatës Themelore dhe jemi njoftuar se është ngritur aktakuza me dt.17.05.2023, pra vetëm katër ditë, pasi që kemi pranuar raportin e ekzaminimit psikitrik, andaj në këtë drejtim jemi të mendimit se është vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të KPPK, dhe është shkelur edhe konventa evropiane për të drejtat e njeriut. Nisur nga të gjitha këto jemi të mendimit se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas vërejtjeve nga aktvendimi i Gjykatës së Apelit, PAKR.420/2023, të dt. 26.09.2023, ku është anuluar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, PKR.188/2023, i dt.30.05.2023, dhe çështja është kthyer në rigjykim e vendosje dhe që të nxjerrët një ekspertizë e nxjerrë në dispozita ligjore, me qëllim që të vazhdohet më tutje me procedurë. Sa i përket gjendjes shëndetësore të të mbrojturit tim edhe sot kam mëdyshje për gjendjen e tij të shëndetit mendor, e sidomos duke pasur parasysh moshën e tij, e po ashtu edhe raportin e ekzaminimit psikiatrik të Institutit të Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë, të dt.15.02.2023, pasi që i njëjti është nxjerrë me shkelje të shumta, andaj rezulton se nuk janë rezultuar edhe dispozitat përkatëse ligjore.

Nga raporti i psikiatrisë forenzike në Prishtinë, nuk është mbërrirë që të epet një konkludim lidhur me gjendjen shëndetësore të akuzuarit në kohën e kryerjes së veprës penale, e njëjta a ka qenë në gjendje të kuptoj rëndësinë e veprimeve të tij, përkitazi me vlerësimin psikologjik të akuzuarit, vetëbesimin të cilin e ka, ndjenjën, andaj që të gjitha këto ekspertizën e bëjnë të pakuptueshëm. Në këtë drejtim jemi të mendimit se ekspertiza përfshihet me shkeljet e ligjit penal, sikurse theksuar më parë, se nuk janë respektuar afatet ligjore, si për nga ekspertimi edhe për nga komunikimi, i përfshirë edhe me gabime të shumta teknike dhe mangësitë që bien ndesh me deklarinimin e ekspertit Dr.Arsim Gashi, i dt.14.03.2024, e po ashtu edhe nga shkresat e tjera të lëndës. Ekspertiza në fjalë është jo profesionale, e cilat mbështetet edhe në provë personale, sikurse është deklarata e të dëmtuarit A.G1., në seancën e dt.14.04.2024, e që të gjitha edhe provat e tjera nga shkresat e lëndës, sikurse janë provat materiale, rezulton se aktgjykimi përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe si i tillë nuk e ka mbështetjen e duhur ligjore.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, sikurse pretendon mbrojtësja e të akuzuarit I.G., av.Myrvete Hashani Jashari, të cilat shkelje janë të parapara në nenin 384 par.1 lidhur me par.2, nën par.2.1 dhe 2.7 të KPPK, që kemi të bëjmë me mos zbatimin e dispozitave të KPPK, nga neni 369 par.7 të KPPK. Po ashtu kolegji ka vlerësuar se në këtë çështje penale nga ana e gjykatës së shkallës së parë, është nxjerrë aktgjykimi PKR.299/23, i dt.17.04.2024, dhe pas vlerësimit të të njëjtit, sipas ankesës së ushtruar, si dhe shkresave të tjera të lëndës, është ardhur në përfundim se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, si dhe me arsyet e dhëna në aktgjykim. Se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, përfshinë të gjitha faktet vendimtare e të cilat e karakterizojnë veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 173 par.1 pika 1.3 lidhur me pikën 1.4 të KPPK, rezulton se nga ana e të akuzuarit, është kryer kjo vepër penale, e me procedimin dhe vlerësimin e të gjitha provave personale dhe materiale, është vërtetuar se në këtë çështje penale janë formuluar elementet qenësore të së njëjtës, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënimi përkatës ligjor.

Po ashtu kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me pretendimin ankimor se në këtë çështje penale nuk është zbutur proceduara, pasi që është kërkuar që të bëhet ekzaminimi i institutit të psikiatrike forenzike në Prishtinë, që nënkupton se është shkelur dispozita ligjore, nga neni 134 par.7 të KPPK, lidhur me nenin 136 të KPPK, duke u ndërlidhur me vendimin për angazhimin e ekspertit, i cili ka kaluar në procedurën e duhur ligjore, si dhe marrjen e raportit të ekspertit lidhur me gjendjen e shëndetit mendor të akuzuarit në kohën e kryerjes së veprës penale. Po ashtu gjykata e shkallës së parë, ia ka përcaktuar detyrimet ekspertit përkitazi me ekspertizën që duhet kryer dhe se e njëjta vazhdimisht duhet të ketë mbështetjen e duhur ligjore, duke iu referuar dispozitës së njëjtë, se pësoni i cili thirret si ekspert, është i obliguar që ti përgjigjet thirrjes dhe të jep rekomandimin e tij në kohë të caktuar. Lidhur me kërkesën e ekspertit organi që e zbaton procedurën mund ta zgjasë afatin për shkaqe të arsyeshme, që nënkupton se çdo gjë që është vepruar në këtë çështje penale, ka qenë brenda afateve kohore, ashtu që pretendimi ankimor se kjo çështje penale është prolonguar që të merret ekspertiza e institutit të psikiatrisë forenzike, sikurse theksohet në ankesë, ka zgjatur nga dt.01.12.2022, gjerë me dt.15.02.2023, plotë 77 ditë, është prolonguar (stërzgatur), nuk qëndron ngase për shkaqe të natyrës së çështjes, edhe ka shkuar më gjatë. Në këtë çështje penale, pasi që është pranuar ekspertiza e institutit të forenzikës, janë ndërmarre veprimet brenda afateve, të dhura ligjore, që nënkupton se nuk është shkelur asnjë nga dispozitat ligjore sikurse referohet nga mbrojtësja e të akuzuarit, që vërtetohet edhe pasi që të vlerësohen të gjitha provat personale ashtu edhe ato materiale, e sidomos pas vlerësimit të dëshmisë së të dëmtuarës A.G., e cila ka deklaruar duke u zbatuar dispozitat përkatëse ligjore, duke thënë se prindërit e saj, kanë pasur momente të mira, por kanë pasur edhe mos marrëveshje të natyrës së ndryshme, duke u shtyrë me fjalë, por dhunë fizike nuk ka pasur asnjëherë. Është evidente se nga ana e prindit është xhelozuar nëna e saj, se ajo po del me dikën tjetër, mirëpo kjo nuk ka qenë e saktë. Po ashtu e njëjta deklaroi se në kohën e fundit ka vërejtur ndryshime te babai i saj, të cilat janë reflektuar në drejtim të tani të ndjerës, të cilës i ka thënë se po përdorë telefonin, dil e flejë në dhomën tjetër, si dhe të tjera. Kjo nënkupton se nga deklarata e së njëjtës, raportet në mes të prindërve të saj, nuk kanë qenë të mira, andaj edhe si rezultat i së njëjtës ka ardhur deri te kjo situatë.

Përkundër asaj se i akuzuari I.G., në mënyrë të tërthortë ka pranuar kryejnë e veprës penale, gjykata e ka vlerësuar këtë deklaram, e pastaj ka bërë vlerësimin edhe të raportit të psikiatrisë forenzike, përkatësisht të ekspertit të IPFK, Dr.Arsim Gashi, e dhënë brenda procedurave ligjore, është konstatuar se te i akuzuari pas ekzaminimit, është përjashtuar çrregullim i kualitetit psikotik akut dhe kronik, prapambetje mendore, apo çrregullimi mendor si pasojë e dëmtimeve Cerebrovaskulare tronore, përkatësisht nuk janë gjetur elementet e natyrës psikiatrike dhe psikologjike që kanë mundur të ndikojnë në aftësinë për të vepruar dhe konstatuar veprimet e veta, se i njëjti mund të marrë pjesë në seancë gjyqësore, si dhe në deponimet e tij, jep autentitetin e të njëjtit që nënkupton se deponimet janë valide. Sa i përket ekspertizës e njëjta është punuar brenda afatit ligjor, andaj janë bërë që të gjitha ekzaminimet, se kanë punuar si ekspert me njohuri të veta profesionale, pa paragjykuar apo menduar nëse i ekzaminuari mund të ketë aftësi të kufizuara, dhe të gjitha këto kanë qar në drejtim të asaj që është dhënë konstatimi sikurse në ekspertizë. Po ashtu nga ekzaminimet e dhëna, është konstatuar se eksperti ka komunikuar me të akuzuarin, dhe se është i vërtet që rezultati i CT, ka rezultuar me disa ndryshime të cilat në fillim kanë menduar se mund të kenë pasur ndikimin në gjendjen psikike të ekzaminuarit, mirëpo që të

gjitha ekzaminimet janë bërë brenda parametrave ligjor, dhe që të gjitha kanë treguar se nuk ka çrregullime mendore për të akuzuarin, me rastin e kryerjes së veprës penale si dhe të njëjtat ekzaminime nuk ekzistojnë, si kanë ekzistuar më parë. I akuzuari ka qenë i vetëdijshëm, e ka kuptuar shumë mire veprën të cilën e ka kryer, mënyrën e kryerjes, veprimet të cilat i ka ndërmarrë edhe pas kryerjes së të njëjtës, se në atë periudhë nuk ka shfaqur keqardhje, dhe se gjatë intervistimit në IPKF, ka deklaruar në detaje për mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe e ka përshkruar në tersi të njëjtën.

Nga kjo rezulton se të gjitha provat materiale dhe personale, në mënyrë të pa dyshimtë kanë vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 173 par.1 lidhur me pikën 1.3 dhe 1.4 të KPK, dhe se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është punuar në kuptim të dispozitës ligjore nga neni 369 të KPPK, përkitazi me përmbajtjen dhe formën e aktgjykimit me shkrim, ngase i njëjti përfshin të gjitha pjesët që duhet ti ketë i njëjti aktgjykim dhe se nuk përfshihet në shkeljet e parapara sikurse pretendohet nga neni 369 par.6 dhe 7 të KPPK, sepse në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyet për çdo pikë të aktgjykimit dhe se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë dhe të plotë ka dhënë arsye të mjaftueshme se për çfarë arsye konsiderojmë të vërtetuara apo të pa vërtetuara të gjitha çështjet e ngritura të cilat rezultojnë nga provat e proceduara dhe vlerësuara në marrjen e aktgjykimit.

Gjithashtu, nga ana e gjykatës së shkallës së parë, në mënyrë të veçantë dhe të qartë janë vlerësuar, saktësia e provave kundërthënëse, të cilat janë sqaruar dhe gjykata ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me të gjitha propozimet e ngritura në zgjidhjen e çështjes, dhe ka dhënë arsye për miratimin apo mos miratimin e të njëjtave, sepse zgjidhjen e çështjes juridiko penale e ka bazuar në vërtetimin e ekzistimit të së njëjtës, dhe përgjegjësisë penalo juridike të akuzuarit.

Po ashtu aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit, është ankimuar për shkak të shkeljeve të ligjit penal, duke theksuar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar në masë të duhur ekzistimin e veprës penale, sikurse është paraqitur në dispozitiv të aktgjykimit, që nënkupton se çështja penale që nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, atëherë kemi të bëjmë edhe me shkeljen e ligjit penal, e sidomos të shpallja e të njëjtit fajtor dhe përgjegjës në aspektin penalo juridik, duke i shqiptar dënimin përkatës ligjor.

Kolegji kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me shkeljet e pretenduara nga ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit, dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale aktgjykimi nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penale, të parapara në nenin 385 të KPPK, ngase vepra penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënimi përkatës ligjor, është i paraparë në ligjin e aplikueshëm sikurse është vepra penale vrasje e rëndë. Nga mënyra e kryerjes së veprës penale, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vlerësuar se në këtë çështje penale i akuzuari e ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 173 par.1 pika 1.3 të KPK, që ndërlidhet me privimin nga jeta të anëtarit të familjes, që në rastin konkret është bashkëshortja, si dhe duke iu referuar pikës 1.4 të të njëjtit ligj dhe të njëjtit nen, privon nga jeta personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake, rezulton pasi që është vërtetuar se ka privuar nga jeta tani të ndjerën S.G., bashkëshorten e vet, derisa e njëjta ka qenë duke fjetur në shtratin e saj, i akuzuari me sëpatë si mjet i posaçëm për shkakimin e lëndimeve të rënda trupore dhe rrezikimin

e jetës e ka goditur të dëmtuarën disa herë në pjesën e majtë të kokës, duke shkaktuar lëndime të rrezikshme për jetë, nga të cilat edhe ka ndërruar jetë, përkatësisht e ka privuar nga jeta, ashtu që duke pasur parasysh mënyrën e kryerjes së të njëjtës, e sidomos raportin e autopsisë të kryer nga ana e institutit të mjekësisë ligjore të dt.04.04.2023. Gjithashtu, kolegji vije në përfundim se pasi që janë vërtetuar elementet qenësore të veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, duke vlerësuar aktgjykimin si tërësi sipas ankesës së ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale nuk ka gjetur arsye se i akuzuari të përjashtohet nga përgjegjësia penale, si dhe ndjekja penale, se gjatë gjyqimit është aplikuar ligji i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale dhe vendimet të cilat janë marrë në këtë çështje penale, e sidomos vendimi për dënimin është marrë në kuadër të dispozitës ligjore, sa i përket karakterit sanksionues, gjithnjë duke pasur parasysh nenin 173 par.1 të KPK “me dënim jo më pakë se 10 vite burgim, ose me dënim të përjetshëm, dënohet personi ..”, që nënkupton se pika 1.3 dhe 1.4 e të njëjtit nen është kuptuar në veprën penale të cilët e ka kryer i akuzuari.

Po ashtu në këtë çështje penale mbrojtësja e të akuzuarit ka ushtruar ankesë për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, si dhe vendimit për shkak të shpenzimeve të procedurës penale, duke thekuar se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në masë të drejtë të gjitha rrethanat me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, duke mos i vërtetuar në këtë çështje penale a ekzaltojnë rrethanat që e përjashtojnë të akuzuarin nga përgjegjësia penale, për shkak të gjendjes së tij të shëndetit mendor, ngase në këtë çështje penale i akuzuari në kohën e kryerjes së veprës penale a ka pasur çrregullime psiqike të kualitetit akut dhe kronik, e po ashtu është dashur të ketë parasysh se i akuzuari a ka qenë në gjendje të plotë mendore, dhe se në kohë të fundit çfarë ka qenë trajtimi i tij. Gjithashtu, është dashur të ketë parasysh se cilat kanë qenë raportet me ish bashkëshorten e vet, si dhe a ka pasur nevojë për trajtim më të afërt nga ana e bashkëshortes, andaj që të gjitha këto rrethana pasi që nuk janë vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë jemi të mendimit se vendimi për dënimin nuk është i drejtë dhe me këtë lloj dënimi nuk pritët të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, se sidomos duke pasur parasysh dispozitën ligjore nga neni 41 i KPK, gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh se si mund të shqiptohet dënimi me burgim të përjetshëm, që në rastin konkret është shqiptuar, për kudër asaj që i akuzuari ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 173 par.1 pika 1.3 dhe 1.4 të KPK. Gjithashtu edhe ngarkimi me shpenzimet e procedurës penale, dhe kompensimin e viktimave të krimit edhe më shumë e rëndon situatën e të akuzuarit, duke pasur parasysh gjendjen e tij financiar, sepse i njëjti të vetmin burim të të ardhurave e ka pensionimin mujor në shumë prej 182 Euro, duke mos realizuar të ardhura të tjera.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, të ushtruar nga ana e mbrojtëses së të akuzuarit I.G., av.Myrvete Hashani Jashari, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, andaj gjykata e shkallës së parë, me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, ka vlerësuar të gjitha rrethanat e parapara në nenin 69 dhe 70 të KPK, kurse si rrethanë lehtësuese e ka pasur parasysh se i akuzuari është i moshë së shtyrë, se për të akuzuarin është kujdesur ish bashkëshortja e ti, se i njëjti nuk ka qenë i punësuar, kurse si rrethana rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës, ashtu që

pasi që ka vërtetuar se vepra penale është kryer në mënyrë mizore dhe dinake, atëherë duke pasur parasysh këto rrethana i ka shqiptuar dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, andaj në prani të këtyre rrethanave ka vlerësuar veprën penale të kryer në kuptim të nenit 173 par.1 lidhur me pikën 1.3 dhe 1.4 të KPPK, sikurse është vepra penale e vrasjes së rëndë, elementet kualifikuese të kryerjes së të njëjtës, sikurse janë pika 1.3 ngase ka privuar nga jeta anëtarin e familjes ish bashkëshorten e vet, se e ka privuar nga jeta në mënyrën mizore dhe dinake, derisa e dëmtuara ka qenë duke fjetur dhe e ka goditur disa herë me sëpatë, andaj duke vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, i ka shqiptuar dënimin me burgim të përjetshëm në kohëzgjatje prej 35 viteve, duke qenë e bindur se me një dënim të këtij lloji, do të arrihet efekti dhe qellmi i dënimit.

Kolegji është i bindur se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, si dhe vendimet e tjera janë bazuar në dispozitat përkatëse ligjore sikurse është neni 462 par.3 i KPPK.

Vendimi mbi paraburgimin është marrë në kuptim të nenit 401 lidhur me nenin 366 par.1 pika 1.1 i KPPK.

Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.312/2024, të datës 04.07.2024

Bashkëpunëtori profesional,
Endrit Ajeti

Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi

Kadrije Goga Lubishtani